



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:173122  
Datë: 06.03.2024  
Numri i dokumentit: 05418263

**C.nr.2898/2022**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me Gjyqtaren Diona Bajrami dhe zyrtaren ligjore A.S. në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses F.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për shkak të kompensimit të shujtave, jashtë seance, me datë 06.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. HEDHET poshtë padia numër C.nr. 2898/2022, e paditëses F.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, lidhur me kompensimin e shujtave, për shkak të gjyqvarësisë (Litispedencës).

**A r s y e t i m**

Paditësja F.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj Av. A. H. pranë kësaj gjykate me datë 29.02.2024 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për shkak të kompensimit të shujtave. Paditësja përmes padisë dhe precizimit të saj të datës 23.02.2024 ka kërkuar nga e paditura që në emër të kompensimit të shujtave për vitin 2021 përkatësisht për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021 për 182 ditë pune t'ia kompensoj shumën prej 364 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me dt.09.02.2024, ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtën së bashku me padinë dhe provat ia ka dërguar të paditurës. Me datë 29.02.2024, Gjykata nga e paditura ka pranuar përgjigjen në padi, me të cilën është njoftuar se për të njëjtën çështje juridike kontestimore paditësja ka parashtruar edhe një padi e cila është e evidentuar nën numrin C.nr.3271/2022, për të njëjtin objekt – kompensim i shujtave për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, andaj pasi që kemi të bëjmë me litispedencë ka kërkuar nga gjykata që e njëjta të hidhet poshtë.

Gjykata pasi analizoi të dy lëndët C. nr. 3271/2022 dhe C. nr. 2898/2022, gjeti së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, më konkretisht edhe nën numrin e lëndës C.nr. 3271/2022, është zhvilluar procedura kontestimore në mes të palëve ndërgjygjese dhe atë në cilësinë e paditëses Fatime Kryeziu nga Prizreni dhe e paditur Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të kontestit kompensim i shujtave për periudhën 01.01.2021-31.12.2021. Gjykata Themelore në Prizren nën numrin e lëndës C.nr. 3271/2022 sipas padisë së paditëses

dhe të tjerëve, ka marrë aktgjykim me dt. 11.07.2023, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit të shujtave dhe atë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 përkatësisht për 182 ditë pune.

Bazuar në nenin 262 par.1 të LPK-së thuhet: “Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia”, në par.3 thuhet: “Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”.

Me që për të njëjtën kërkesë është duke u zhvilluar një procedurë tjetër gjyqësore midis palëve të njëjta, gjykata në kuptim të nenit 262 par.3 të LPK-së, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të litispëndencës.

Vendimi mbi shpenzimet e kësaj procedure është marr në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
Cnr.2898/2022, 06.03.2024

Gjyqtarja

---

Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.